

BIBLIOTEKA

814-1

295

SHELSH

GJIROKASTER

FATBARDH  
RUSTEMI

NË  
KTHJELLTËSINË  
ESYVE

Poezi

891.983-1

8JH-1  
RPS

Fatbardh Rustemi

NË KTHJELLTËSINË  
E SYVE

poezi

32956

SHTËPIA BOTUESE  
«NAIM FRASHËRI»

Redaktor *Egypsiab Ristemi*  
PERIKLI JORGONI

NG KTHETITSENİ  
ESSAYE

poesi

38198

SHÝMÁ BOTAEZ  
NAUD ERASHER.

## BUZËQESHJA E NGROHTE

Pallton lija varur në klasë,  
kur kthehesha, gjeja në xhepa arra, portokaj...  
I pyesja nxënësit, kush m'i kishte sjellë,  
sytë e qeshur dukeshin pa faj.

U thashë të mos më sillnin,  
për mësuesin nuk ishte mirë,  
në xhepa ata prapë fusnin  
mollë dhe ftonj të arrirë.

Pallton nisa ta mbaja veshur,  
në klasë e heq dhe e vesh,  
por në tavolinë prapë gjeja  
një verigë rrush e një shegë.

## BUZËQESHJA E NGROHTE

U shqetësova dhe më kapi trishtimi,  
mos filluan që tani të tjerrin dredhitë,  
si disa që për t'ia arritur qëllimin  
i zënë eprorët në gracka birrarish.

Buzëqeshja e ngrohtë, e pastër,  
e heshtur diçka më thosh:  
«T'i sollëm që bukuritë e fshatit  
edhe ti, mësues, t'i provosh!»

Kush m'i sillte kurrë s'e mësova,  
pa dyshim që të gjithë ata,  
në kthjelltësinë e syve të tyre  
veç çiltërsi të pafundme ka!

## ANKESA E ZOGJVE SHTEGTARË

Ne shtegtojmë, vazhdimisht shtegtojmë,  
pas ndjekim pranverën luleplot,  
kalojmë kështu shtete, male, dete...  
Vallë, a ka pranverë në botë?!

Ne zogjtë shtegtarë me këtë mënyrë jetese  
pas pranverës rendim pérherë.  
Vallë, bukurinë e saj magjepse  
cili prej nesh e ka ndjerë?

Edhe pse pranverën pas e ndjekim,  
pranverë në botë s'ka,  
sot luftërat ashpër ndezin,  
i varfri bëhet më fukara!

## ANKEZA E ZOGJAC SHTEGOTARE

Krahë kemi, po nuk fluturojmë,  
në qiel avionët vjellin zjarr.  
Krahët tanë çdo ditë po degradojnë,  
qiel të lirë për zogjtë s'ka!

Veçse në Shqipëri gjejmë pranverë,  
qielli është atje veçse për zogjtë,  
veç atje lulja e sigurt çel,  
veç atje ulesh i sigurt në tokë!

## BISEDË E BARIUT ME QENIN

Bashkë kemi fjetur, Balo, në stanë,  
njëri-tjetrin kemi ndihmuar sa herë,  
mbështetesh tek unë kur jam i qeshur,  
larg më rri kur bëhem i sërtë.

Të mbaj mirë, Balo, e ti rrithesh,  
s'jam i pashpirt të të lë të uritur...  
Kur dhëmbët e ujkut të kanë gjakosur  
eh, sa shumë më je dhimbsur!

Ti s'je si qentë e borgjezit, Balo,  
që hipin veturave e rrojnë si princër,  
ku rrugëve, bulevardeve e qosheve  
zgjasin duart mijëra të uritur!

BLËNDË E GARTUT ME GENIT

Ti je kafshë, Balo, e e ke rrojtjen tënde,  
më mirë se njeriu s'ke pse të rrash.  
Mes tufës së dhenve bardhoshe  
njihem unë e jo ti për zot!

## FĒMIJËT NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Eein kurjozë e shikojnë,  
kapur radhë-radhë në përparëse.  
Qeshin, luajnë e ngacmojnë  
kafshët mbyllur në kafaze.

Ujkun e urejnjë si imperialist,  
dhelprën e përbuzin si tradhtare  
Ndalin, shohin si lëviz  
shqiponjë e rreptë e krënare.

Shpesh njerëzit pas kafshëve  
kanë fshehur veten e qëllimet,  
se ka pasur edhe ka ende në botë  
kohë të egra despotike.

## EMRIU NË KORPSHINI ZOGFOGJIK

Në përralla flet ujku si mbret,  
flet kuçedra, tigri e katallani.  
Edhe zëri i poetit  
fshihet në një zog mali.

Hiqni kafshët në përralla  
si në teatër maskat heqin,  
do të shihni veçse klasat,  
do të shihni veçse njerëzit!

## PUNĘTORĘT KANĘ HIPUR NĘ SKENĘ

Ulem nę shkallët e kinoteatrit  
akoma tē pandërtuar.  
Kudo skela  
lëvizje punętorësh  
dhe mure tē pasuvatuar.

Ulem dhe shoh nę skenë  
një vajzë që saldon mbi skelë  
e xixat si xixéllonja  
i sillen asaj përreth!

Një djalë më tutje, më pas  
fërshëllen diçka nëpër buzë,  
më tej me zë tē lartë  
i thërret shokut dikush.

Punojnë të heshtur,  
bëjnë shaka  
dhe shtrohen në pushim të hanë,  
si kudo dhe në skenë.  
punëtorët ngjiten më parë!

12

## NJË RAST NGA JETA

Ty të rëndohej nëna e dhimbsur,  
e largove me grindje e sherr,  
televizorin hap i magjepsur,  
mbyll i kënaqur frigorifer.

Nga puna i lodhur kur vije,  
nëna të priste me sytë nga udha,  
bukën e ruante nga mizat  
e të ledhte me duart e buta.

Gjellën frigoriferi e mban,  
por s'ka aty merak prej nëne,  
magjia dhelëse e gruas  
të ndez ca ndjenja të këndshme!

Kështu i largove duart e ngrohta,  
në dyqan çorape leshi merr,  
«Të shkojë te vëllai e motra,  
kanë detyrime dhe të tjerë!»

Deshët apartament të ri,  
pa nënën nuk u përkiste,  
po si ta thërrisnit atë përsëri  
pas gjithë atyre mërzive?

Nënën e kërkonin fëmijët,  
meraku i fqinjëve përreth,  
por dhe ty të mori malli  
si dikur t'i vije kokën në prehër.

Ajo erdhi e urtë dhe e dhimbur,  
nis të qeshë prapë duke harruar gjithçka...  
Si mund për ca ndjenjëza të vockla  
të sakrifikohen ndjenjat e mëdha?!

## KUR RRITEK VIZATORET

Dikur në krah të mbaja,  
kur fëmijë akoma ishe.  
Kur me duart e vockla  
flokët m'i shprishje.

Ti rritesht e fustani s'të bën,  
në fund palët zë e i shton,  
ky vështrimi i djemve tek ti  
diçka të mirë seç trazon,

Ti fqinj, ke hyrë tamam në jetë  
dhe fytyra të ka marrë një pamje  
serioze,  
bile, dhe muq kur më sheh,  
më kalon anash me drojtje.

## TELEFONI DHE SHKESI

Telefoni në tavolinë  
rri i mbledhur kruspull,  
ndofta nga të ftohtët,  
ndofta ish përgjumur.

Shkesi me borsalinë  
të vjen ty çdo natë,  
të shtëpisë seç mblidhen  
e s'të lënë rehat!

Seç të sillen rrotull,  
sa shumë të mundojnë,  
me një tjetër burrë  
duan të të martojnë.

Ashtu si qëmoti  
mbyllur në shtëpi,  
«A merr ç'të jep shkesi,  
a rri në vetmi?!»

Shkesi si të shkelë  
dashurinë e re,  
kur telefon i heshtur  
bën sikur fle?!

Ai prap' mund të zgjohet  
si nga një èndërr e bukur,  
dhe djali që ti do  
pranë teje të rri ulur.

Telefoni i shkathët  
me zilkën «cërr-cërr»  
mbi dashurinë tuaj  
këndon pérherë.

## SI MUND TË JESH SOT I QETË?

Si mund të jesh sot i qetë,  
kur krejt si pemë armët janë maskuar?  
Si mund t'i gëzohesh agimit të trëndafiltë  
kur Çeku gdhihet i pushtuar?

Kaltërsi e qiejve dhe oqeaneve  
s'është më kaltërsi,  
enden në to flotat ushtarake,  
gjithë tmerr e egërsi.

Veçse në vendin tim pemët janë vetëm pemë,  
kërpudhat s'të kujtojnë bombën atomike,  
kaltërsia e detit dhe e qiellit tonë  
s'ka kurrë djallëzinë e shpikjeve.

## KUR LARG MEJE...

Kur larg meje ike qetësish,  
burrë më të sigurtë në Tiranë gjete,  
ndjeva në vetvete gabimisht  
pazotësinë e një djali ndaj një femre.

Me vete mendoja, kushedi,  
mbasë dhe unë kam faj ndopak...  
Ti përbuze qytetin tonë të ri,  
të jetojë në një qytet të madh.

Brengë ime s'ra në sytë e njerëzve,  
s'brodha rrugëve me cigare,  
veçse ndonjëherë thosha me vete:  
«Pse s'ndodhi kjo më parë?»

Ndodh me tët shoq të vish këndej,  
jo si dikur e bukur gjithë freski,  
dicka e madhe te ti është rrëzuar,  
por ja, s'mund ta ngresh përsëri.

Bukuria jote mos viente për më tepër?  
Ndaj na përbuze me qytetin bashkë...  
Veç ta dish, ne ta shohim brengën,  
që më kot mundohesh ta përbash!

## NË TOKË ULESHIN ZOGJTË

Në tokë uleshin zogjtë  
vetëm sa për t'u çlodhur,  
ndërsa myzeqari në tokë  
shtyhej baltërave i lodhur...

Hija e beut si ankth rrinte pezull  
dhe më e frikshme se beu ajo ish,  
hija e tij si mani persekutimi  
sillej në èndrrat e fëmijëve gjithë frikë.

Mbi tokën tonë, shokë, tani  
jemi më të lirë nga zogjtë vëtë,  
mjafton që të jesh zot i tokës  
që të përkasin ty dhe qiejt.

## NIE TOKKE URFESINN ZOGTE

Hop ndizet vallja, shpérthen gëzimi,  
valltari me pëllëmbë tokën rreh,  
sikur do t'i thotë pér të njëmijtën herë  
tani zot mbi ty jemi ne!

Tokën bashkuam si zemrat në luftë,  
syri fshatar u mbush me hapësirë,  
tokës me grushte farën i hodhëm,  
asaj s'i durohej sa të bëheshin kallinjtë.

Lulja e diellit kë pret  
me atë fytyrë diellore si fëmijë kurjoz?  
Kujt i pérulet gruri më aq respekt  
kë vallë ai nderon?

## ANTIBURSKATIKE

Nderojnë ato punëtorin,  
nderojnë fshatarin,  
që diçka nga shpirti i vet  
në bukurinë e fushës la...  
Ndërsa bejlerët si dordolecë i varim  
grunjrave të trembin harabela!  
  
Ata që silleshin si shpirt i keq,  
që bënин ligjin skëterrë,  
ligjin idiot,  
tani nga frika e tyre  
tremben veçse zogjtë.

## ANTIBUROKRATIKE

Në përgjegjësi u ngrite, shok i dashur,  
të më shohësh nga vatura qëllon shpesh.  
Vallë, pse më vështron vrazhdë,  
kokën mezi tund kur të përshëndes?!

Në bankë kur ishim dikur bashkë,  
për vajzat që deshëm flisnin deri vonë,  
Për interes këto kurrë s't'i thashë,  
ka diçka që zemra s'e harron!

Nuk më dhemb shpirti në mërzi,  
ç'pandeh, se zilia më trishton?  
Ç'zemër mund të ketë ai njeri  
kur suksesi i shokut s'e gëzon?!

SHOBETËMI I POSTIERTIT

Dicka tjetër shpirtin ma trazon,  
ti po hedh nga vetja pjesën më të mirë!  
Nga xhami i veturës përherë më shikon  
si dicka që kurrë s'kam për ta arrirë.

Oh, ti hodhe pjesën më të mirë,  
ndaj nga posti ne të ulëm prapë,  
ne s'i kemi postet e veturat  
për t'u mburrur e të zësh rehat!

## SHQETËSIMI I POSTIERIT

Të shoh pérherë, shoku postier,  
me hapin tënd të menduar...

Pérherë me vete them:  
«Shkon te të rintjtë pér t'i gjuar!».

Ç'të ka hipur një brengë e të mundon,  
në sytë e botës kërkon të mos bjerë,  
nga jot bijë e ke siç thonë  
se dashuroka një të krishterë.

Shoku postier, s'mund të të shfaqësoj,  
bota e vjetër s'është zhdukur akoma.  
Hija e saj akoma do të na mundojë  
me drama pér gjëra të vockla!

Pa ditur letrat në çantë ia mban,  
ia dërgon në shkollë e uzinë...  
Vajzës i thua të mos e marrë,  
por letrat ia mban të gjitha mbi shpinë!

Të shoh pérherë, shoku postier,  
me hapin tënd të menduar,  
dhe pérherë me vete them:  
«Shkon te të rinjtë pér t'i gëzuar!».

## VEPRA E JO FJALE

Pambuku gonxhet i hapi lehtë,  
ndofta nga dëshira që të flasë.  
Vallë, q'do të jetë ajo e fshehtë  
që në heshtje krijon ditë e natë?

U hapën gonxhet, s'thanë ašgjë...  
E përse? S'duhej asnjë fjalë,  
përderisa i ngrohtë dhe i butë  
ndriste pambuk i bardhë.

## V A Z H D I M Ė S I

Në mbrëmje vonë  
xhaxhai para se të vdiste,  
siç e kishte zakon,  
orën kërkoi të kurdiste.

E kurdisi mirë e mirë,  
e vuri në vesh, mua ma dha,  
të rrahurat e zemrës së tij  
orës, siç duket, ia la.

## MBRËMJE TË LUMTURA SAV

Ciftet dy nga dy shëtisin mbrëmjeve të lumtur, prania e tyre e bën mbrëmjen edhe më të bukur.

Në krahun tim mbështetesh dhe ecim, në rrugën e qetë, te kthesa e rrugës ndahemi, atje ku shpesh më pret.

Aty ku ne ndahemi shpesh, ndizet e shuhet një neon, sikur qëllimi shyrin shkel:  
«Po ju pse kaq vonë?»

## NISET DJALI

(*Motiv popullor*)

Niset djali vrulltas më varkë  
kundër lumit të rrëmbyer,  
pak më poshtë e pak më lart  
priste vajza syshkruar.

Dhe i thoshte djali lumit,  
valët rrihte me lopata:  
«Përse je kaq i keq, o lumië,  
pse s'më lë të shkoj te vajza?»

Lumi djalit ia kthen shpejt  
duke e shtyrë si me dorë:  
«Fajin s'e kam unë, or djalë,  
por e ka mali me borë!»

Edhe djali i tha erës,  
malit plak ajo t'i thosh:  
«Pse je kaq i keq, o mal,  
ngaqë s'di të dashurosh?»

I kish thënë mali erës  
që t'i thoshte djalit të mirë:  
«Fajin, pra, e kishte dielli,  
ngaqë borën i kish shkrirë.»

«Peshk i lumit do të bëhem,  
përmes lumin ta kaloj...»  
Nga ky hall i madh ndoshta  
këtë varg dikush krijoi.

## DUA APO S'DUA

Sa herë kaloj dritares sate,  
doja apo s'doja, sytë i hidhja lart.  
Dhe gjithçka bëhej e gjëzuar  
si qyteti kur bie bora e parë.

Vitet rrodhën qysh atëherë ngadalë,  
me familje u largove nga qyteti ynë,  
dhe atje patjetër ndonjë djalë  
ndizet nga dashuria për ty.

S'do të qortoj për dashurinë e harruar,  
vetëm diçka po të them:  
kur kaloj andej, dua apo s'dua,  
sytë nga dritarja më venë!

## ATA QË LAJKA I BËNIN DIKUR

Mbylli sytë Stalini i madh  
që mijérave në botë ua çeli,  
Brutët e Makbethët moderne  
mbi trupin e tij hiqeshin sikur prekeshin.

Kush tha se Stalini s'është më i gjallë,  
se përvdekjen e tij njerëzit pëshpërisin?  
Ai rri i shtrirë dhe fle duke parë  
një ëndërr të madhe për komunizmin.

Ata që lajka i bënин dikur,  
që emrin e tij s'e hiqnin nga goja,  
u sulën kundër kufomës së tij  
se i gjallë u dukej akoma.

Me djegien e tij ata nuk u ngopën,  
u sulën sérishmi gjithë egërsi,  
prisnin nga çasti në çast Hrushovët  
që Stalini të vdiste përsëri.

Sa qesharake të ndeshesh me një të vdekur,  
sa qesharake të ndeshesh me një të pavdekshëm,  
sa qesharake të ndeshesh me statujën e bronzë  
që lavdinë më lart do t'ia ngrenë shekujt!

## EPOS

Eposi homerik ka 28 000 vargje,  
28 000 bij ka dhe eposi i Luftës sonë Çlirimtare.

Në vend të çdo vargu epika e çdo dëshmori, pavdekësia.  
Nëse nga Troja mbeti vetëm «Iliada»,  
te ne e përjetshme Shqipëria!

## NË PRAG TË PËRURIMIT

Piedestali pa statujë ka disa ditë,  
pritet të ngjitet në të heroi.  
Pritet të vijë ai,  
që mal më mal e shteg më shteg luftoi.

E çuditshme vërtet,  
gjithë kohën si mund të rri aty ndenjur,  
ai që sa mbaronte një betejë,  
nxitonte shpejt te një tjetër!

## BANOR I QYTETIT JE

Dhe pse shokë fëmijërie  
rritur bashkë në mjerim,  
aparat fotografie  
s'shkrepi kurrë për kujtim...

Rri i bronztë në piedestal,  
banor i qytetit je,  
përshëndet ti me dorë  
kur kalojmë pranë atje.

Plot njerëz rreth teje ka,  
aty bëjnë fotografi,  
ja, drejt teje lulet zgjat  
me plot mall një fëmijë.

ДЕА НИВАНИ МОТИХИ

Majë këmbëve është ngritur,  
tufë lulesh po të zgjat,  
hape pak dorën e bronztë,  
gishtat e mbledhur hapi pak!

Bashkë bëmë një kujtim,  
është kjo një pozë e rrallë,  
sup më sup dy shokë rrinë,  
një i bronztë dhe një i gjallë!

## ÇETA HAPIN NXITON

E heshtur ecën çeta nëpër shi  
me armët hedhur mbi xhaketa,  
i kalon ajo fshatit përbri  
se diku e pret beteja.

Natë, re, baltë e shi  
dhe asgjë më veçse terr.  
ecën partizani Ali  
përbri fshatit të vet.

Ecën e kërkon të shohë fshatin,  
ecën e përfytyron të shoqen lehonë,  
ecën dhe pret dikush t'i sjellë lajmin...  
por çeta hapin nxiton!

## KUR NË QIELL RA NJË YLL

*Motiv popullor*

*Kushtuar dëshmorit Riza Kaposhi*

Djalë, shpesh të pata thënë,  
mos më dil natën pa hënë.

Se në natën sterr' të zezë,  
përgjon pushkë e pabesë.

Por ti, biro, fillikat  
more rrugën nëpër natë.

Dhe në natën sterr' të zezë  
seç u shkrepën ca dyfekë.

Dhe ti, biro, sytë mbyll,  
kur në qiel ra një yll.

Qiellit yjet po rrallojnë,  
çetat yjet po i shtojnë.

## FISHEKËT E AMANETIT

Kur u vra ai,  
kobures i mbetën disa fishekë pa zbrazur,  
dora e tij s'mundte më  
të shkrehte armën...

Shokët koburen me fishekë  
e sollën në shenjë kujtimi në muzeum,  
kokëpërpjetë rrinin fishekët  
si një urrejtje e pashprehur deri në fund.

Po qe se ujqit imperialistë  
atdheut i sulen për gjak të etur,  
në gojë do t'ia zbraz fishekët e mbetur  
si një urrejtje tashmë e shprehur!

## KËSHTJELLA E KRUJËS

Kështjellë e Krujës,  
o moj lavdiplotë,  
prapa krahëve të tu  
u fsheh një Evropë.

Mbi gjoksin tënd  
u derdh një Azi.  
Po si nuk lëvize  
nga vendi pak ti?!

Pas shpinës Venediku  
të qëllonte tinëz.  
Kujt t'i ktheje gjoksin,  
kujt t'i ktheje shpinën?!

Ja, u shfaqe ti  
prapë në Evropë,  
as pesë shekuj, moj,  
nuk të mundën dot!

## KUR NXITONIN AMBASADORËT

Nxitonin ambasadorët  
e Evropës dhe Azisë  
me dhurata,  
lajka,  
përulje për sulttanin e Turqisë.

Shpresonin në paqen e madhe  
ambasadorët e ndritshëm, lajkatarë...  
Gjithkush nxitonte nga ankthi  
se kush të arrinte më parë.

Ziente Ederneja nga pritjet pompoze,  
nga darkat e drekat në ekstazë.  
Gjithkush përpiquej që luftën  
nga vetja ta hiqte sa më larg.

Ambasadorët e ndritshëm, lajkatarë,  
nga gjithë bota u sulën drejt Turqisë...  
Në sarajet e sulltan Mehmetit mungonte  
vetëm ambasadori i Shqipërisë.

## NJË TJETËR KA AGUAR

Vallë ç'ndjeu humbëtira e heshtur,  
ç'ndjeu pajetësia e tokës,  
kur u shfaq mahnitshëm njeriu  
me magjité çudibërëse të dorës?!

Në botën e rendit primitiv,  
ku të gjithë ishin njësoj;  
një tjetër botë nis të shfaqej  
me zjarr e hekur, tmerr e thonj!

U duk se çdo gjë e humbi lidhjen  
se asgjë s'ish më e bërabartë,  
oh, ky njeri që në botë erdhi  
mos do të zhdukej prapë?!

Fytyrë skllavopronare mori shekulli,  
zakonet, luftërat, rrobat...  
Por ish diçka që pareshtur  
në brendësi ndryshonin kohërat.

Një fytyrë tjetër po krijohej  
me veshjet, ligjet e shtetet...  
Ish bota feudale që gjithçkaje  
fytyrës së saj i jepte.

Edhe në botën feudale të mbretërve  
në brendësi pareshtur ndryshonte diçka,

edhe pse e pandryshueshme në pamje,  
tezgjahu tirrte ndryshime të mëdha!

Bota borgjeze me kthetra mizore,  
me zjarr, hekur, tinguj, reklamë...  
Çdo gjëje të kësaj bote  
fytyrën e saj përpinqet t'i japë.

Në botën borgjeze u shfaq  
një botë e madhe e mahnitshme,  
kjo botë e zjarrtë përfaket  
nga ngjyrë e kuqe e komunistëve

## KUNDËR ASNJANËSISË

— Në botën e kapitalit —

Sot në shekullin XX  
të atomit e të shpejtësisë reaktive,  
u nda shoqëri e qenëve  
në klasë të varfër e të zotërinjve.

Fle qeni në një shtrat me zonjën,  
i bëhen varrime madhështore.  
Sa mijëra të tjerë lëngojnë  
e ngordhin për një copë kockë!

Qentë po ndahan në klasa fisonore,  
çdo gjë e kësaj bote po ndahet sakaq.  
A ka gjë më absurde në këtë shekull  
sesa të thuash: «Jam asnjanës»?!

## DALIM ME NATË...

(Monolog i një minatori brazilan)

Dalim me natë, vëlla,  
dhe me natë hyjmë në minierë,  
po si nuk u pamë bashkë  
sy më sy njëherë, o diell!

Nxjerrim ar vezullues,  
ar të kuqërremtë, rubin...  
Gjithë ky ar që nxjerrim  
si s'na e ndryshoi pak varférinë?

Gjithë jetën kështu në nëntokë  
dhe vdekja dihet po kështu,  
veçse ndryshimi është se vdekjes  
do t'i rrish: gatitu!

Padroni të mban të kërrusur,  
të fut dhjetëra metra thellë,  
galeritë si dhomat e ferrit,  
ku shpirti pak e nga pak të del.

Dhe s'mund të thuash: «Jam gjallë!»  
S'mund të thuash: «Po jetoj!»  
Përderisa në tokë vetëm flemë  
e dritën e diellit nuk e shikojmë.

Kur vlera e djersës sonë  
në vlerën e arit mbetet pérherë,  
ajo ndrit në çdo sallon  
e në çdo veturë shkëlqen.

Sa galeri kemi hapur  
të frikshme, të errëta si ferr...  
Por ne do të shihemi njëherë bashkë  
sy më sy, o diell!

## HAKMARRJE, SHPËRTHE!

Në zgavrën e një peme shekullore  
għidha proletari i' njié vendi borgjez  
bashkë me proletarin kilian Jozef  
në guva e strofka kafshet flenë.

Tek ecte një ditë nē rrugêt e qytetit  
pranë vitrinave që i ngacmonin urinë,  
ni si tē mendonte këto mrekullira  
nga duart e kujt vijnë?

Parasysh i dolən miliona njerëz,  
që nuk bënna nga ai jetë më tē mirë.  
«Pér dorën tonë nē këtë botë pérse  
gjithçka eshtë e paarrirë?»

## BURRAT E SUPERHETEVE

Shkoi të flejë në shtëpizën-zgavër  
me hakmarrjen me shekuj të vjetër...  
Por në zgavrën e pemës së moçme  
ish harruar dikush tjetër.

«Fli, shok i dashur, nuk do të të ngas,  
nga zgavra ime nuk do të të përzë,  
dikush dhe mua ma ka lënë,  
ashtu si sonte unë po të lë.»

Hakmarrje, shpërthe sa të gjithë vullkanët  
ç'do humbasim kur s'kemi asgjë!  
Do ta bëjmë këtë botë varfanjakësh  
jona të mbetet përgjithnjë!

## BURRAT E SUPERSHTETEVE

Burrat e supershteteve  
vijnë në Helsinki e në Gjenevë hijerëndë,  
ballëmenduar,  
me lëvizje të matura,  
me fjalë të hedhura «gjithë mençuri»,  
thua se serioziteti i njerëzimit  
varur në buzë u rri.

Thua se burrërinë veç në ato fytyra e gjen,  
thua se s'ka pasur kurrë njerëz kaq seriozë,  
thua se plagët e njerëzimit  
u therin deri në kockë...

Pikërisht në këto momente pompoze,  
mes kësaj ekstaze për paqen «që na pret»,  
nga poligonet e shpërthimeve atomike  
vjen një gjëmim që xhamave kërcet.

## LEGENDA E MINIMI

(Në vjetrit të parë, këngët e shumta)

Megjithatë burrat e shteteve pinë nga një gotë  
pastrojnë zërin. Japin një buzëqeshje të lehtë,  
dhe për paqen vazhdojnë të flasin  
me të njëjtin pompozitet.

## LEGJENDA E MURIMIT

Të vrasin kriminelët në mes të ditës  
në «demokracinë» e botës borgjeze,  
trupin ta fshehin tinëz  
në shtylla betoni, në mure ndërtese.

Ndriçon pallati nga mermeri,  
nga pasqyrat, neonët e reklamat...  
ndërsa brenda mureve të trasha  
janë murosur të vrarët.

C'është legjenda e murimit  
nisur e frikshme nga lashtësitë,  
para fshehjes së krimit  
me lustrën e demokracisë?!

## QENDRIMI VERTIKAL

(Në vendet borgjeze e revizioniste)

Kudo shantazhe  
presione,  
provokacione,  
bllokada...  
Duan ta përulin njeriun  
me bomba atomike,  
me — izma,  
dhe ikona të akullta!

Njeri të bëhej majmuni  
qëndrimin vertikal arriti në shekuj,  
vallë, a mund të kërruset tani  
me kamzhik e hekur?!

## ZJARRI I REVOLUCIONIT

(stalinistkun a usteindz zebha 30)

Férkoi njeriu i lashtë dy copa dru  
dhe, pér qudi, zjarri u shfaq...  
S'e la tē shuhej nga akullnajat,  
por tē ndezur e mbajti sakaq.

Kur njeriu ruajti zjarrin  
nē sende tē thata, pa jetë,  
si tē mos e ruante atë  
nē thellësi tē qenies së vet!?

## PAQJA E LUFTËN XITËSVE

Sallat

e konferencave të pagues  
harbohen  
nga dritat,  
reflekset,  
ngjyrat...

Priten

të vijnë  
burrat e shteteve  
ardhur  
nga grindjet  
e luftërat.

Vijnë si perandorë

sultani  
mbretër

me pamje

dhe më madhështore,

në vend

    të topave të kështjellës  
përshëndesin

    shpërthimet bërthamore.

Gazetarët

    njëri-tjetrin shtyjnë

    kush të arrijë më parë,  
blicët ndizen e shuhën

    si neonë të prishur.

Nga kjo madhështi

    si gjithnjë do të dalë  
një buzëqeshje e hidhur.

O Helsinki naiv,

    pas pagues i marrë,

o Gjenevë,

«asnjanëse»,

    e brishtë!

Në Luftën e Dytë

    a s'ratë më parë  
viktima të mjera

    të sulmit fashist?!

Militarizohet

toka

oqeanet

qiejt,

kudo grushte shteti

provokacione

dhe kjo egërsi mbulohet lehtë  
në ekranet e televizorëve.  
Në kufij shtetesh  
enden flotat ushtarake  
si vdekje  
në kulmin e urisë,  
që nga çasti në çast  
pret rastin,  
shtete e kombe të gëlltisë.  
Lëmshi i kontradiktave  
është lidhur gogël,  
vatra lufte janë hapur kudo.  
Mund të shërbejë  
dhe një shkëndijë e vogël,  
që njerëzimi në luftë  
veten të shohë.  
Në botën e kapitalit  
terror, përleshje,  
gjak, termometri i ngritjes së çmimeve  
e tregon të sëmurë  
borgjezin plak.

Popujt

s'e mbajnë më zemërimin,  
ndër damarë  
gjak i nxeh të  
rrjedh.

Plaka krizë

si «Rrezik vdekje»  
me fytyrat e zonjave shëmbëllen.

Papritur

zbresin diplomatët  
me avion nga qiejt,

atje ku lufta  
është ndezur zjarr,  
drejtimin luftës

t'ia ndryshojnë  
sa më shpejt  
si perënditë e hershme  
në «Iliadë».

Zbresin

e ulen  
në kolltukët e rehatshëm

larg kufomave,  
sakatëve,

shkatërrimeve,  
hakmarrjen

që zien ndër damarë

ta ftohin  
në tavolinën e bisedimeve.

Revolucionin  
duan ta mbysin  
me flota ushtarakë,  
buzëqeshje,  
— izma

burg...

Sado gurë  
e plehra

të hedhin në krater  
shpërthimi është i sigurt.

Grushti proletar  
s'fshihet më në xhepa,

si gjyle  
i vërtitet

borgjezit kokës  
ky grusht,

me një të goditur  
i ndryshon rrötullimin tokës!

Ej, shekulli, XX,  
I çudirave,

i tmerreve,  
i shpresave të mëdha,

shekull i lartësive  
dhe i poshtërimeve hata!

Shekull antitezë,  
shekull kuqezi,

shekull titanësh

dhe xhuxhmaxhuxhësh

Mendohej

je ti.

në lashtësinë e hershme  
se bota

mbështetëj

mbi tri balena.

Ndodhnin të frikshme

tërmete,

kur inatosej

a mërzitej ndonjëra.

Mbi shpatullat e popujve

mbështetet

i rëndë sa gjithësia

rruzulli tokësor.

Kur popujt

inatosen nga zemërimi,

gjithçka tronditet

në REVOLUCION.

## PËRMBAJTJA

Buzëqeshja e ngrohtë .....	3
Ankesa e zogjve shtegtarë .....	5
Bisedë e bariut me qenin .....	7
Fëmijët në kopshtin zoologjik .....	9
Punëtorët kanë hipur në skenë .....	11
Një rast ngajeta .....	13
Kur rriten vajzat .....	15
Telefoni dhe shkësi .....	16
Si mund të jesh sot i qetë? .....	18
Kur larg meje.. .....	19
Në tokë uleshin zogjtë .....	21
Antiburokratike .....	24
Shqetësimi i postierit .....	26
Vepra e jo fjalë .....	28
Vazhdimësi .....	29
Mbrëmje të lumtura .....	30
Niset djali .....	31
Dua apo s'dua .....	33
Ata që lajka i bënин dikur .....	34
Epos .....	36
Në prag të përurimit .....	37
Banor i qytetit je .....	38
Ceta hapin nxiton .....	40
Kur në qìell ra një yll .....	41
Fishekët e amanetit .....	43
Kështjella e Krujës .....	44
Kur nxitonin ambasadorët .....	46
Një tjetër ka aguar .....	48
Kundër asnjanësisë .....	51
Dalim me natë... .....	52
Hakmarrje, shpërthe! .....	54
Burrat e supershteteve .....	56
Legjenda e murimit .....	58
Qëndrimi vertikal .....	59
Zjarri i revolucionit .....	60
Paqja e luftënxitësve .....	61